# TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

| | |
|---|---|
| DIREKTIVA 2007/2/KE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE KËSHILLIT e Mars 2007 e cila themelon një Infrastrukturë për Informacionin Hapësinor në Komunitetin Evropian (INSPIRE) | **1. Ligjin nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”;**<br>**2. Vendim nr. 547, datë 28.9.2023 “Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore të Sistemit Informacionit Gjeografik (GIS)””;**<br>**3. Vendim nr. 399, datë 19.6.2019 “Për rregullat për shkëmbimin e grupeve dhe të shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore ndërmjet autoriteteve publike”;**<br>**4. Vendim nr. 38, datë 18.1.2017 “Për miratimin e rregullave të ndërveprueshmërisë të të dhënave, grupeve të të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore”;**<br>**5. Vendim nr. 1077, datë 23.12.2015 për miratimin e rregullores "Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë";**<br>**6. Urdhër nr. 44, datë 28.03.2023 për një ndryshim në Urdhrin nr.40, datë 20.02.2020 të Kryeministrit “Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Bordit të Informacionit Gjeohapësinor”;**<br>**7. Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.**<br><br>Përputhshmëri e pjesshme |

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Neni (Direktiva)** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| Neni 1 (1) | Qëllimi i kësaj Direktive është të parashtrojë rregullat e përgjithshme, që synojnë ngritjen e Infrastrukturës për Informacionin Hapësinor në Komunitetin Evropian (më tej referuar si Inspire), për qëllim të politikave komunitare mbi mjedisin dhe politikat apo aktivitetet, që mund të kenë ndikim në mjedis. | | | Ky ligj përcakton rregullat për:<br>a) krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë;<br>b) organizimin dhe funksionimin e autoriteteve kombëtare të informacionit gjeohapësinor;<br>c) përcaktimin e kushteve të përgjithshme që lidhen me mbledhjen, krijimin, përpunimin, përditësimin, ndërveprimin, aksesin, ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e informacionit gjeohapësinor;<br>ç) detyrimet dhe kompetencat e autoriteteve publike për krijimin, sigurinë, aksesin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.2 | Inspire do të ndërtohet mbi infrastrukturën për informacionin hapësinor, që është ngritur dhe operohet nga Shtetet Anëtare. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 1.(a) | Ky ligj përcakton rregullat për: a) krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë; | E plotë | |
| 2.1 | Kjo direktivë nuk cenon Direktivat 2003/4/KE dhe 2003/98/KE. | | | | Nuk transpozohet | |
| 2.2 | Kjo Direktivë nuk ndikon në ekzistencën apo zotërimin e të drejtave të pronësisë intelektuale të autoriteteve publike | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 15.3 | Për grupet e të dhënave gjeohapësinore, për të cilat një palë e tretë gëzon të drejta të pronësisë intelektuale, autoriteti publik nuk mund të veprojë në zbatim të këtij ligji pa pëlqimin e kësaj pale. | E plotë | |
| 3 (1) | Për qëllim të kësaj Direktive, do të zbatohen përkufizimet vijuese: 1. 'infrastrukturë për informacionin hapësinor' nënkupton metadata, grupe dhe shërbime të dhënash hapësinore; shërbimet dhe teknologjitë e rrjetit; marrëveshjet mbi ndarjen, qasjen dhe përdorimin; mekanizmat e koordinimit dhe monitorimit, proceset dhe procedurat e ngritura, që operojnë ose janë të disponueshme në përputhje me këtë Direktivë; | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 3.12 | "Infrastruktura kombëtare e informacionit gjeohapësinor" është infrastruktura që përfshin autoritetet kombëtare përgjegjëse për të dhënat gjeohapësinore, metadatat, grupet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore, shërbimet e rrjetit dhe teknologjitë, marrëveshjet për shkëmbimin, aksesin dhe përdorimin, si dhe mekanizmat e koordinimit e të monitorimit, proceset dhe procedurat, të krijuara, të vëna në veprim ose të vëna në dispozicion në përputhje me këtë ligj. | E plotë | |
| 3 (2) | 'të dhëna hapësinore' nënkupton çdo të dhënë me një referencë | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe | "Informacion gjeohapësinor" janë metadatat, të dhënat dhe grupet e të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | direkte ose indirekte për një vendndodhje specifike ose zonë gjeografike; | | funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 3.11 | dhënave gjeohapësinore, që lidhen me një fenomen çfarëdo të realitetit, gjeoreferencimi i të cilit mundësohet nga një sistem hapësinor koordinativ i përbashkët. | | |
| 3 (3) | grup të dhënash hapësinore' nënkupton një mbledhje të identifikueshme të të dhënave hapësinore; | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 3.8 | "Grup të dhënash gjeohapësinore" është një koleksion i identifikueshëm të dhënash gjeohapësinore. | E plotë | |
| 3 (4) | shërbimet e të dhënave hapësinore' nënkupton operacionet që mund të kryhen, duke aktivizuar një aplikacion kompjuteri, në të dhënat hapësinore përfshirë në grupet e të dhënave hapësinore ose në metadatat përkatëse; | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 3.17 | "Shërbime për informacionin gjeohapësinor" janë operacionet që mund të realizohen, përmes aplikacioneve kompjuterike, për informacionin gjeohapësinor, të dhënat dhe grupet e të dhënave gjeohapësinore ose për metadatat që lidhen me to. | E plotë | |
| 3 (5) | 'objekt hapësinor' nënkupton një prezantim abstrakt të një fenomeni të një bote të vërtetë lidhur me një vendndodhje specifike ose zonë gjeografike; | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 3.19 | "Objekt gjeohapësinor" është përfaqësimi abstrakt i një fenomeni të botës reale lidhur me një vend ose zonë gjeografike të veçantë. | E plotë | |
| 3 (6) | 'metadata' nënkupton informacionin që përshkruan grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore dhe mundësimin e zbulimit, inventarit dhe përdorimit të tyre; | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 3.14 | "Metadata" është informacioni që përshkruan të dhënat, grupet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet që lidhen me to, të cilat mundësojnë zbulimin, inventarizimin dhe përdorimin e të dhënave e të grupeve të të dhënave gjeohapësinore. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 (7) | ‘ndërveprim’ nënkupton mundësinë e kombinimit të grupeve të të dhënave hapësinore dhe ndërveprimin e shërbimeve, pa një ndërhyrje përsëritëse manuale, në një mënyrë të tillë që përfundimi të jetë koherent dhe vlera e shtuar e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave të rritet; | | Ligji nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë” Neni 3.15 | . “Ndërveprueshmëria” është aftësia e sistemeve të ndryshme për të punuar bashkë, pa ndërhyrje manuale të përsëritura, në mënyrë që rezultati i bashkëveprimit të jetë i qartë dhe të çojë në rritjen e vlerës së shtuar të grupeve dhe shërbimeve të të dhënave. | E plotë | |
| 3 (8) | ‘Gjeo-portali Inspire’ nënkupton një faqe interneti, ose e barasvlershme me të, e cila ofron qasje në shërbimet e referuara në Nenin 11(1); | | Ligji nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë” Neni 3.10 | “Gjeoportal” është një sistem, i cili nëpërmjet internetit përdor një ndërfaqe grafike qendrore dhe unike, nëpërmjet së cilës përdoruesit mund të zbulojnë, të shikojnë dhe të përdorin informacionin gjeohapësinor dhe shërbimet e rrjetit që lidhen me këtë informacion, sipas përcaktimeve të këtij ligji. | E plotë | |
| 3 (9) | ‘autoriteti publik’ nënkupton:<br>(a) çdo qeveri ose administratë tjetër publike, përfshi organet publike të këshillimit në nivel kombëtar, rajonal ose lokal;<br>(b) çdo person fizik ose juridik, që kryen funksione publike administrative sipas ligjit kombëtar, përfshi detyra specifike, aktivitete apo shërbime lidhur me mjedisin; dhe<br>(c) çdo person fizik ose juridik që ka përgjegjësi ose funksione publike, ose që ofron shërbime publike për mjedisin sipas kontrollit të një organi ose personi ku bëjnë pjesë (a) ose (b) | | Ligji nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë” Neni 3.2 | “Autoritet publik” është:<br>a) çdo organ i pushtetit qendror dhe vendor, që kryen funksione administrative, si dhe entet publike që kryejnë funksione administrative;<br>b) çdo person fizik ose juridik, që ka përgjegjësi ose kryen funksione publike apo që ofron shërbime publike nën kontrollin e autoriteteve të parashikuara në shkronjën “a” të kësaj pike. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shtetet Anëtare mund të argumentojnë se kur organe ose institucione veprojnë brenda kapacitetit juridik ose legjislativ, nuk do të konsiderohen si autoritet publik për qëllim të kësaj direktive; | | | | Nuk transpozohet | |
| 4 (10) | 'palë e tretë' nënkupton çdo person fizik ose juridik përveç autoritetit publik. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br>Neni 3.16 | "Palë e tretë" është çdo person fizik ose juridik, i ndryshëm nga autoriteti publik i përkufizuar në pikën 2 të këtij neni. | E plotë | |
| 4 (1) | Kjo Direktivë do të përfshijë grupet e të dhënave hapësinore,<br>të cilat plotësojnë kushtet vijuese:<br>(a) ato lidhen me një zonë ku një Shtet Anëtar ka dhe/ose<br>ushtruar të drejta juridiksionale;<br>(b) janë në formatin elektronik;<br>(c) mbahen nga ose në emër të ndonjërit nga të mëposhtmeve:<br>(i) një autoritet publik, pasi është prodhuar ose pranuar<br>nga një autoritet publik, ose po menaxhohet ose<br>përditësohet nga ai autoritet dhe që përfshihet brenda<br>sferës së detyrave publike;<br>(ii) një palë e tretë për të cilën rrjeti është bërë i<br>disponueshëm në përputhje me Nenin 12;<br>(d) ato lidhen me një pse më shumë tema të listuar në Aneksin<br>I, II ose III. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br>Neni 2 | Ky ligj zbatohet për të gjitha metadatat, grupet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet e tyre që<br>plotësojnë kriteret e mëposhtme:<br>a) lidhen me një ose më shumë nga temat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij;<br>b) lidhen me zona brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;<br>c) janë në format elektronik;<br>ç) mbahen nga dhe për llogari të:<br>i) një autoriteti publik, kur janë prodhuar ose janë marrë nga një autoritet publik apo administrohen<br>ose përditësohen nga ky autoritet dhe përfshihen në fushën e veprimtarisë së tij;<br>ii) një pale të tretë, së cilës i janë vënë në dispozicion shërbimet e rrjetit të të dhënave gjeohapësinore,<br>në përputhje me këtë ligj. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 (2) | Në rast kur ka kopje të shumta identike të të njëjtës kulturë të dhënash hapësinore mbahen ose janë në emër të autoriteteve të ndryshme publike, kjo Direktivë do të zbatohet vetëm në versionin e referencës nga i cili rrjedhin kopjet e ndryshme. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 2.2 | Në rastet kur ekzistojnë kopje identike të shumëfishta që u përkasin të njëjtave të dhëna gjeohapësinore, të cilat mbahen nga ose për llogari të autoriteteve publike, ky ligj zbatohet vetëm për versionin origjinal të të dhënave gjeohapësinore, prej të cilit janë krijuar kopjet e tjera. | E plotë | |
| 4 (3) | Kjo Direktivë do të përfshijë gjithashtu shërbimet e të dhënave hapësinore në të dhënat ku mbahen të dhënat hapësinore në paragrafin 1. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 2.1 | Ky ligj zbatohet për të gjitha metadatat, grupet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet e tyre që plotësojnë kriteret e mëposhtme:<br>a) lidhen me një ose më shumë nga temat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij;<br>b) lidhen me zona brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;<br>c) janë në format elektronik;<br>ç) mbahen nga dhe për llogari të:<br>i) një autoriteti publik, kur janë prodhuar ose janë marrë nga një autoritet publik apo administrohen ose përditësohen nga ky autoritet dhe përfshihen në fushën e veprimtarisë së tij;<br>ii) një pale të tretë, së cilës i janë vënë në dispozicion shërbimet e rrjetit të të dhënave gjeohapësinore, në përputhje me këtë ligj. | E plotë | |
| 4 (4) | Kjo Direktivë nuk kërkon mbledhjen e të dhënave të reja hapësinore. | | | | Nuk transpozohet | |
| 4 (5) | Në rast të grupeve të të dhënave hapësinore, të cilat përputhen me | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe | Për grupet e të dhënave gjeohapësinore, për të cilat një palë | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kushtin e parashtruar në paragrafin 1(c), por palët e treta kanë të dhëna të pronësisë intelektuale në lidhje me këtë.<br>Autoriteti publik mund të ndërmarrë veprim sipas kësaj Direktive<br>vetëm me miratimin e palës së tretë. | | funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br>Neni 15.3 | e tretë gëzon të drejta të pronësisë intelektuale, autoriteti publik nuk mund të veprojë në zbatim të këtij ligji pa pëlqimin e kësaj pale. | | |
| 4 (6) | Duke anashkaluar paragrafin 1, kjo Direktivë do të përfshijë<br>grupet e të dhënave hapësinore nga ose në emër të një autoriteti<br>publik duke operuar në nivelin më të ulët të qeverisjes brenda një<br>Shteti Anëtar, nëse Shteti Anëtar ka ligje ose norma që kërkojnë<br>mbledhjen ose përhapjen e tyre. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br>Neni 12,14, 15 | **Neni 12**<br>Mbledhja, përpunimi dhe përditësimi i të dhënave gjeohapësinore për secilën nga temat e përcaktuara nga neni 11 i këtij ligji, kryhen në përputhje me vendimet e ASIG-ut për secilën temë.<br>2. Në vendimin e ASIG-ut për secilën temë identifikohen autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore përkatëse, si dhe përcaktohen afatet për mbledhjen e të dhënave dhe depozitimin e tyre pranë këtij autoriteti.<br>3. Autoritetet publike, të identifikuara sipas pikës 2 të këtij neni, mbledhin, përpunojnë dhe përditësojnë të dhëna gjeohapësinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimet e ASIG-ut, si dhe depozitojnë pranë këtij autoriteti të dhënat gjeohapësinore të mbledhura në afatin e përcaktuar prej tij.<br>4. ASIG-u, pasi të ketë marrë më parë mendimin e BIG-ut për | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përputhshmërinë e tyre me kërkesat/kushtet e përcaktuara, miraton ose refuzon përfshirjen në GIS-in Kombëtar të të dhënave të mbledhura në përputhje me këtë nen.<br>5. Vendimi i ASIG-ut për miratimin e të dhënave gjeohapësinore dhe përfshirjen e tyre në GIS-in Kombëtar publikohet në Gjeoportalin Kombëtar, si dhe u komunikohet me shkrim autoriteteve publike përgjegjëse, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së këtij vendimi.<br>6. Vendimi i ASIG-u për refuzimin e përfshirjes së të dhënave gjeohapësinore në GIS-in Kombëtar shoqërohet me arsyetimin përkatës dhe u përcillet me shkrim autoriteteve publike përgjegjëse, duke përcaktuar afatin, brenda të cilit këto autoritete duhet të adresojnë shkaqet e refuzimit, të sqaruara në arsyetimin e vendimit.<br><br>**Neni 13**<br>Metadatat<br>1. Autoritetet publike përgjegjëse për krijimin ose mbajtjen e të dhënave gjeohapësinore, të parashikuara në nenin 2 të këtij ligji, në bashkëpunim me ASIG-un, krijojnë, mbledhin dhe përditësojnë metadatat për këto të dhëna, në përputhje me këtë ligj dhe me rregullat e përcaktuara me vendim të Këshillit të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Ministrave, me propozimin e ministrit.<br>2. Metadatat përmbajnë informacion për:<br>a) përputhshmërinë e grupeve të të dhënave gjeohapësinore me rregullat e ndërveprueshmërisë së grupeve të të dhënave gjeohapësinore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit;<br>b) kushtet në lidhje me aksesin dhe përdorimin e grupeve të të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore dhe, kur është rasti, edhe për tarifat korresponduese;<br>c) cilësinë dhe vlefshmërinë e grupeve të të dhënave gjeohapësinore;<br>ç) autoritetet publike përgjegjëse për krijimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e grupeve të të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore;<br>d) kufizimet për aksesin publik dhe arsyet e këtyre kufizimeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 25 të këtij ligji.<br>3. Autoritetet publike përgjegjëse për krijimin e metadatave sigurojnë që metadatat të jenë të plota dhe në një cilësi të tillë që të plotësojnë qëllimin e përcaktuar në pikën 13 të nenit 3 të këtij ligji.<br>4. Rregulla më të hollësishme për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, për strukturën e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | katalogimit të metadatave, si dhe për afatet për krijimin e metadatave specifike për temat e parashikuara në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, të propozuar nga ministri, pasi të ketë marrë miratimin e BIG-ut dhe duke mbajtur në konsideratë standardet europiane ekzistuese për këtë qëllim dhe kërkesat për përdoruesit.<br><br>**Neni 14**<br>Ruajtja dhe arkivimi i të dhënave gjeohapësinore dhe metadatave<br>1. ASIG-u është institucioni përgjegjës për përcaktimin e kushteve për ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave gjeohapësinore dhe metadatave, të cilat mbahen nga autoritetet publike përkatëse dhe ASIG-u.<br>2. Në përcaktimin e kushteve për ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave gjeohapësinore dhe metadatave, ASIG-u mban në konsideratë legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore. | | |
| 4.7 | Përshkrimi i temave të të dhënave ekzistuese referuar në Anekset I, II dhe III mund të përshtaten në përputhje me procedurën rregullatore shqyrtuese referuar në Nenin 22(3), në mënyrë që të merret parasysh zhvillimi i | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 11.3 | Listës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni i shtohet çdo temë tjetër e përcaktuar, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit, në përputhje me nevojat dhe zhvillimet në | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | nevojave për të dhënat hapësinore në mbështetje të politikave komunitare, që ndikojnë në mjedis. | | | fushën e informacionit gjeohapësinor dhe në përputhje me përparësitë e politikës kombëtare të informacionit gjeohapësinor. | | |
| 5.1 | Shtetet Anëtare do të sigurojnë që metadatat krijohen për grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore, që korrespondojnë me temat e listuar në Anekset I, II dhe III dhe këto metadata mbahen të përditësuara. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br><br>Neni 13.1<br><br>Vendim nr. 1077, datë 23.12.2015 për miratimin e rregullores "Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë"; | Autoritetet publike përgjegjëse për krijimin ose mbajtjen e të dhënave gjeohapësinore, të parashikuara në nenin 2 të këtij ligji, në bashkëpunim me ASIG-un, krijojnë, mbledhin dhe përditësojnë metadatat për këto të dhëna, në përputhje me këtë ligj dhe me rregullat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit | E plotë | |
| 5.2 | Metadatat do të përfshijnë informacionin në vijim:<br>(a) përshtatja e grupeve të të dhënave hapësinore me implementimin e rregullave parashikuar në Nenin 7(1);<br>(b) kushtet që aplikohen për qasjen në grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore dhe përdorimin e tyre dhe, sipas rastit, tarifat përkatëse;<br>(c) cilësia dhe vlefshmëria e grupeve të të dhënave hapësinore;<br>(d) autoritetet publike përgjegjëse për ngritjen, menaxhimin, | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br>Neni 13.2 | | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore; (e) kufizime të qasjes publike dhe arsyet për kufizime të tilla, në përputhje me Nenit 13. | | | | | |
| 5.3 | Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar që metadatat të jenë të plota dhe të një cilësie efikase për të përmbushur qëllimin e përcaktuar në pikën (6) të Nenit 3. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 13.3 | Metadatat përmbajnë informacion për: a) përputhshmërinë e grupeve të të dhënave gjeohapësinore me rregullat e ndërveprueshmërisë së grupeve të të dhënave gjeohapësinore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit; b) kushtet në lidhje me aksesin dhe përdorimin e grupeve të të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore dhe, kur është rasti, edhe për tarifat korresponduese; c) cilësinë dhe vlefshmërinë e grupeve të të dhënave gjeohapësinore; ç) autoritetet publike përgjegjëse për krijimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e grupeve të të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore; d) kufizimet për aksesin publik dhe arsyet e këtyre kufizimeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 25 të këtij ligji. | E plotë | |
| 5.4 | Rregullat e implementimit të këtij | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe | **Neni 13/4** Rregulla më të hollësishme për krijimin, | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Neni do të miratohet brenda 15 Maj 2008 në përputhje me procedurën rregullatore referuar në Nenin 22(2). Këto rregulla do të marrin parasysh standardet përkatëse ekzistuese ndërkombëtare dhe kërkesat e përdoruesit, në veçanti në lidhje me vërtetimin e metadatave. | | funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br>Neni 13.4, 27.3<br><br>Vendim nr. 1077, datë 23.12.2015 për miratimin e rregullores "Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë"; | ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, për strukturën e katalogimit të metadatave, si dhe për afatet për krijimin e metadatave specifike për temat e parashikuara në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, të propozuar nga ministri, pasi të ketë marrë miratimin e BIG-ut dhe duke mbajtur në konsideratë standardet europiane ekzistuese për këtë qëllim dhe kërkesat për përdoruesit.<br>**Neni 27/3**<br>Këshilli i Ministrave, brenda 3 muajve nga fillimi i veprimtarisë së ASIG-ut, miraton aktet nënligjore të parashikuara nga neni 13 pika 4, neni 16 pika 1, neni 18 pika 3 dhe neni 19 pika 3 të këtij ligji, në bazë të parimeve të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji. | | |
| 6 | Shtetet Anëtare do të krijojnë metadata referuar në Nenin 5 në përputhje me kalendarin vijues:<br>(a) jo më vonë se 2 vjet pas datës së adoptimit të implementimit të rregullave në përputhje me Nenin 5(4) në rastin e grupeve të të dhënave hapësinore, që korrespondojnë me temat e listuar në Anekset I dhe II;<br>(b) jo më vonë se 5 vjet pas datës së datës së adoptimit të implementimit të rregullave në përputhje me Nenin 5(4) në rastin e grupeve të të dhënave hapësinore, që korrespondojnë me temat e listuar në Anekset III. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br>Neni 27/3<br><br>Vendim nr. 1077, datë 23.12.2015 për miratimin e rregullores "Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë" | Këshilli i Ministrave, brenda 3 muajve nga fillimi i veprimtarisë së ASIG-ut, miraton aktet nënligjore të parashikuara nga neni 13 pika 4, neni 16 pika 1, neni 18 pika 3 dhe neni 19 pika 3 të këtij ligji, në bazë të parimeve të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji. | E plotë | |
| 7.1 | Implementimi i rregullave që përcaktojnë marrëveshjet teknike | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe | ASIG-u, në bashkëpunim me autoritetet publike përkatëse, harton | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | për ndërveprim dhe, sipas rastit, harmonizimi i grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore, projektuar për të amenduar elemente jo thelbësorë të kësaj Direktive duke e plotësuar atë, do të miratohet në përputhje me procedurën rregullatore shqyrtuese referuar në Nenin 22(3). Kërkesat përkatëse të përdoruesit, nismat ekzistuese dhe standardet ndërkombëtare për harmonizimin e grupeve të të dhënave hapësinore, si dhe konsideratat për fizibilitetin dhe përfitimet në kosto do të merren parasysh në zhvillimin e implementimit të rregullave. Aty ku organizata të themeluara sipas të drejtës ndërkombëtare kanë miratuar standarde përkatëse për të siguruar ndërveprimin ose harmonizimin e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore, këto standarde do të integrohen dhe mjetet ekzistues teknike do t'i referohen, nëse është e përshtatshme, implementimit të rregullave të përmendura në këtë paragraf. | | funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br>Neni 18.3, 18.4<br><br>Vendim nr. 38, datë 18.1.2017 "Për miratimin e rregullave të ndërveprueshmërisë të të dhënave, grupeve të të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore"; | rregulla të hollësishme për realizimin e ndërveprueshmërisë dhe, pasi të ketë marrë mendimin e BIG-ut, ia përcjell ato ministrit për propozim për miratim në Këshillin e Ministrave. Këto rregulla duhet të përmbajnë parashikime edhe për aspektet e mëposhtme:<br>a) një kuadër të përbashkët për identifikimin unik të objekteve gjeohapësinore, identifikuesit e të cilëve mund të përcaktohen në hartë, me qëllim sigurimin e ndërveprueshmërisë midis tyre;<br>b) lidhjen midis objekteve gjeohapësinore;<br>c) atributet kryesore dhe sinonimet shumëgjuhëshe korresponduese;<br>ç) informacionin për dimensionin kohor të të dhënave;<br>d) përditësimet e të dhënave.<br>4. Rregullat për ndërveprueshmërinë, sipas pikës 3 të këtij neni, duhet:<br>a) të sigurojnë përputhshmërinë midis zërave të informacionit që i referohen së njëjtës vendndodhje ose të njëjtit objekt të paraqitur në shkallë të ndryshme;<br>b) të sigurojnë që informacioni i nxjerrë nga grupe të ndryshme të dhënash gjeohapësinore është i krahasueshëm për sa i përket aspekteve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni. | | |
| 7.2 | Si një bazë për zhvillimin e rregullave të implementimit | | | | Nuk transpozohet | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | parashikuar në paragrafin 1, Komisioni do të ndërmarrë analiza për të siguruar që rregullat janë të realizueshme dhe proporcionale në aspektin e kostove dhe përfitimeve të tyre të mundshme dhe do të ndajnë rezultatet e analizave të tilla me komitetin e referuar në Nenin 22(1). Shtetet Anëtare, bazuar në një kërkesë, do t'i ofrojnë Komisionit informacionin e nevojshëm për t'i mundësuar të ndërmarrin analiza të tilla. | | | | | |
| 7.3 | Shtetet Anëtare do të sigurojnë që të gjitha strukturat e reja të mbledhura gjerësisht dhe shërbimet përkatëse të të dhënave hapësinore janë të disponueshme në përputhje me implementimin e rregullave referuar në paragrafin 1 brenda dy viteve nga adoptimi i tyre, dhe se komplete dhe shërbime të tjera të dhënash hapësinore ende në përdorim janë të disponueshme në përputhje me implementimin e rregullave brenda shtatë vitesh nga adoptimi i tyre. Grupet e të dhënave hapësinore do të bëhen të disponueshme me implementimin e rregullave ose përmes përshtatjes së grupeve ekzistuese të të dhënave hapësinore ose përmes shërbimeve të transformimit referuar në pikën (d) të Nenit 11(1). | | Ligji nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë” Neni 18.1 | ASIG-u, në bashkëpunim me autoritetet publike përkatëse, merr masat e nevojshme për të siguruar ndërveprueshmërinë e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore, për të dhënat gjeohapësinore ekzistuese dhe për ato që mblidhen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, si dhe për metadatat korresponduese. | E plotë | |
| 7.4 | Rregullat e implementimit referuar në paragrafin 1 do të | | Ligji nr.72/2012, “Për organizimin dhe | Me qëllim sigurimin e ndërveprueshmërisë së grupeve dhe | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përfshijnë përkufizimin dhe klasifikimin e objekteve hapësinore<br>lidhur me grupet e të dhënave hapësinore të temave listuar në<br>Aneksin I, II dhe III dhe mënyra në të cilën këto të dhëna hapësinore kanë një gjeo-referencë. | | funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br>Neni 18.2 | shërbimeve të të dhënave<br>gjeohapësinore, ASIG-u, në bashkëpunim me autoritetet publike përkatëse, përcakton përkufizimin dhe<br>klasifikimin e grupeve të të dhënave gjeohapësinore, që lidhen me temat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 11 të<br>këtij ligji, si dhe për mënyrën e gjeoreferencimit të këtyre të dhënave gjeohapësinore. | | |
| 7.5 | Përfaqësues të Shteteve Anëtare në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal si dhe persona të tjerë fizikë apo juridikë me një interes në të dhënat hapësinore, që lidhen me rolin e tyre në<br>infrastrukturën e informacionit hapësinor, përfshi përdorues,<br>prodhues, ofrues shërbimesh me vlerë të shtuar ose çdo organ<br>koordinues do t'i jepet mundësia për marrë pjesë në diskutimet përgatitore për<br>përmbajtjen e rregullave të implementimit referuar në paragrafin<br>1, para se të merret parasysh nga Komiteti referuar Nenit 22(1). | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br>Neni 18.3<br><br>Urdhër nr. 44, datë 28.03.2023 për një ndryshim në Urdhrin nr.40, datë 20.02.2020 të Kryeministrit "Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Bordit të Informacionit Gjeohapësinor" | ASIG-u, në bashkëpunim me autoritetet publike përkatëse, harton rregulla të hollësishme për<br>realizimin e ndërveprueshmërisë dhe, pasi të ketë marrë mendimin e BIG-ut, ia përcjell ato ministrit për propozim për miratim në Këshillin e Ministrave. Këto rregulla duhet të përmbajnë parashikime edhe për<br>aspektet e mëposhtme:<br>a) një kuadër të përbashkët për identifikimin unik të objekteve gjeohapësinore, identifikuesit e të cilëve mund të përcaktohen në hartë, me qëllim sigurimin e ndërveprueshmërisë midis tyre;<br>b) lidhjen midis objekteve gjeohapësinore;<br>c) atributet kryesore dhe sinonimet shumëgjuhëshe korresponduese;<br>ç) informacionin për dimensionin kohor të të dhënave;<br>d) përditësimet e të dhënave. | E plotë | |
| 8.1 | Në rastin e grupeve të të dhënave hapësinore, që i<br>korrespondojnë një ose më shumë tema të listuar në Aneksin I ose II, | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të | Me qëllim sigurimin e ndërveprueshmërisë së grupeve dhe shërbimeve të të dhënave<br>gjeohapësinore, ASIG-u, në | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | rregullat e implementimit parashikuar nga Neni 7/1) do të plotësojnë kushtet e përcaktuara në paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni. | | Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 18.2 | bashkëpunim me autoritetet publike përkatëse, përcakton përkufizimin dhe klasifikimin e grupeve të të dhënave gjeohapësinore, që lidhen me temat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji, si dhe për mënyrën e gjeoreferencimit të këtyre të dhënave gjeohapësinore. | | |
| 8.2 | Rregullat e implementimit do të adresojnë aspektet vijuese të të dhënave hapësinore:<br>(a) një strukturë të përbashkët për identifikimin unik të<br>objekteve hapësinore ku mund të hidhen në hartë<br>identifikuesit sipas sistemeve kombëtare për të garantuar<br>ndërveprim mes tyre;<br>(b) marrëdhënia mes objekteve hapësinore;<br>(c) cilësitë kyçe dhe fjalori përkatës shumë gjuhësh, i cili kërkohet për politikat që kanë ndikim në mjedis;<br>(d) informacion mbi dimensionin e përkohshëm të të dhënave;<br>(e) përditësime të të dhënave. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br>Neni 18.3 (a,b,c,d) | ASIG-u, në bashkëpunim me autoritetet publike përkatëse, harton rregulla të hollësishme për<br>realizimin e ndërveprueshmërisë dhe, pasi të ketë marrë mendimin e BIG-ut, ia përcjell ato ministrit për propozim për miratim në Këshillin e Ministrave. Këto rregulla duhet të përmbajnë parashikime edhe për aspektet e mëposhtme:<br>a) një kuadër të përbashkët për identifikimin unik të objekteve gjeohapësinore, identifikuesit e të cilëve mund të përcaktohen në hartë, me qëllim sigurimin e ndërveprueshmërisë midis tyre;<br>b) lidhjen midis objekteve gjeohapësinore;<br>c) atributet kryesore dhe sinonimet shumëgjuhëshe korresponduese;<br>ç) informacionin për dimensionin kohor të të dhënave;<br>d) përditësimet e të dhënave. | E plotë | |
| 8.3 | Rregullat e implementimit do të projektohen për të siguruar përputhshmëri mes artikujve të informacionit, të cilat i referohen të njëjtës vendndodhje ose mes artikujve të informacionit, që i | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" | Rregullat për ndërveprueshmërinë, sipas pikës 3 të këtij neni, duhet:<br>a) të sigurojnë përputhshmërinë midis zërave të informacionit që i referohen së njëjtës vendndodhje ose të njëjtit objekt të paraqitur në | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | referohen të njëjtit objekt prezantuar në shkallë të ndryshme. | | Neni 18.4(a) | shkallë të ndryshme; | | |
| 8.4 | Rregullat e implementimit do të projektohen për të siguruar që informacioni, i cili rrjedh nga struktura të ndryshme hapësinore është i krahasueshëm për sa i përket aspekteve referuar Nenit 7(4) dhe paragrafit 2 të këtij Nenin. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 18.4(b) | të sigurojnë që informacioni i nxjerrë nga grupe të ndryshme të dhënash gjeohapësinore është i krahasueshëm për sa i përket aspekteve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni. | E plotë | |
| Art. 9 | Rregullat e implementimit parashikuar në Nenin 7(1) do të miratohen në përputhje me kalendarin e mëposhtëm:<br>(a) jo më vonë se 15 Maj 2009 në rastin e grupeve të të dhënave hapësinore, që iu korrespondojnë temave të listuar në Aneksin I;<br>(b) jo më vonë se 15 Maj 2012 në rastin e e grupeve të të dhënave hapësinore, që iu korrespondojnë temave të listuar në Aneksin II ose III. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 12.3, 17.3 | **Neni 12.3**<br>Autoritetet publike, të identifikuara sipas pikës 2 të këtij neni, mbledhin, përpunojnë dhe përditësojnë të dhëna gjeohapësinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimet e ASIG-ut, si dhe depozitojnë pranë këtij autoriteti të dhënat gjeohapësinore të mbledhura në afatin e përcaktuar prej tij.<br>**Neni 17.3**<br>Autoritetet publike depozitojnë menjëherë pranë ASIG-së sistemet e informacionit gjeografik, të krijuara sipas pikës 2 të këtij neni. | E plotë | |
| 10.1 | Shtetet Anëtare do të garantojnë që çdo informacion, përfshi të dhëna, kode dhe klasifikime teknike, të cilat duhen për përputhjen me rregullat e implementimit parashikuar nga Neni 7(1) të bëhet i disponueshëm për autoritetet publike ose palët e treta në përputhje me kushtet, që nuk kufizojnë përdorimin për këtë qëllim. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 18.5 | Çdo informacion i nevojshëm për përputhshmërinë me rregullat e ndërveprueshmërisë, të miratuara në përputhje me këtë nen, përfshirë edhe të dhëna, kode dhe klasifikime teknike, u vihet në dispozicion autoriteteve publike dhe palëve të treta, sipas kushteve që nuk kufizojnë përdorimin e këtij infomacioni për këtë qëllim. | E plotë | |
| 10.2 | Për të garantuar që të dhënat | | Ligji nr.72/2012, "Për | Për të siguruar përputhshmërinë e të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | hapësinore lidhur me një veçori gjeografike, vendndodhja e të cilës shtrihet mes kufijve të dy ose më shumë Shteteve Anëtare, janë koherente, Shtetet Anëtare, sipas rastit, do të vendosin me miratim reciprok mbi përshkrimin dhe pozicionin e veçorive të tilla të përbashkëta. | | organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br>Neni 18.6 | dhënave gjeohapësinore, që lidhen me një fenomen që shtrihet midis kufirit shqiptar dhe atij të një shteti tjetër, përshkrimi dhe vendndodhja e këtij fenomeni të përbashkët vendoset me pëlqimin e të dyja shteteve. | | |
| 11.1 | Shtetet Anëtare do të ngrenë dhe operojnë një rrjet shërbimesh të mëposhtme për grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore për të cilat janë krijuar metadata në përputhje me këtë Direktivë:<br>(a) shërbime zbuluese bëjnë të mundur kërkimin e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore bazuar në përmbajtjen e metadatave përkatëse për të shfaqur përmbajtjen e metadatave;<br>(b) shërbime pamore duke bërë të mundur, si një kërkesë minimale, shfaqjen, navigimin, zmadhimin /zvogëlimin, panoramimin, ose mbulimin e grupeve të të dhënave hapësinore dhe shfaqjen e informacionit të legjendave dhe çdo përmbajtje përkatëse të metadatave;<br>(c) shkarkimi i shërbimeve, duke mundësuar kopje të grupeve të të dhënave hapësinore, ose pjesë të grupeve të tilla, për t'u shkarkuar dhe, sipas rastit, për t'u aksesuar direkt; | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br>Neni 23.1<br><br>Vendim nr. 547, datë 28.9.2023 "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore të Sistemit Informacionit Gjeografik (GIS)"" | ASIG-u vë në dispozicion të publikut të dhënat gjeohapësinore, për të cilat janë krijuarmetadata, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, përmes një rrjeti që ofron shërbime:<br>a) kërkimi, me anë të të cilave bëhet i mundur kërkimi i grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore, në bazë të metadatave korresponduese dhe shfaqja e përmbajtjes së këtyre metadatave;<br>b) konsultimi, me anë të të cilave bëhen të mundur minimalisht shfaqja, lundrimi, zmadhimi apo zvogëlimi, shtresëzimi i grupeve të të dhënave gjeohapësinore që shfaqen dhe shfaqja e legjendës së informacionit dhe të çdo përmbajtjeje relevante të metadatave;<br>c) shkarkimi, me anë të të cilave mundësohet shkarkimi i kopjeve ose pjesëve të grupeve të të dhënave gjeohapësinore dhe, kur është rasti, aksesi i drejtpërdrejtë me to;<br>ç) transformimi, me anë të të cilave mundësohet transformimi i grupeve | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (d) shërbime transformimi, duke mundësuar grupe të të dhënave hapësinore për t'u transformuar me qëllim arritjen e ndërveprimit;<br>(e) shërbime që lejojnë përdorimin e shërbimeve të të dhënave hapësinore.<br>Këto shërbime do të marrin parasysh kërkesat përkatëse të përdoruesit dhe do të jenë të lehta në përdorim, të disponueshme për publikun dhe të aksesueshme përmes Internetit ose çdo mjeti tjetër të përshtatshëm telekomunikacioni. | | | të të dhënave gjeohapësinore, me qëllim realizimin e ndërveprueshmërisë;<br>d) që lejojnë evokimin e shërbimeve për të dhënat gjeohapësinore. | | |
| 11.2 | Për qëllim të këtyre shërbimeve referuar pikës (a) të paragrafit 1, si një kërkesë minimale do të implementohet kombinimi vijues i kritereve të kërkimit:<br>(a) fjalët kyçe;<br>(b) klasifikimi i të dhënave dhe shërbimeve hapësinore;<br>(c) cilësia dhe vlefshmëria e grupeve të të dhënave hapësinore;<br>(d) shkalla e përputhshmërisë me rregullat e implementimit | | Ligji nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”<br>Neni 23.3 | Për shërbimin e parashikuar nga shkronja “a” e pikës 1 të këtij neni duhet të zbatohet minimalisht kombinimi i mëposhtëm i kritereve të kërkimit:<br>a) fjalët kyçe;<br>b) klasifikimi i të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimeve që lidhen me to;<br>c) cilësia dhe vlefshmëria e grupeve të të dhënave gjeohapësinore;<br>ç) shkalla e përputhshmërisë me rregullat e ndërveprueshmërisë, të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | parashikuar nga Neni 7(1);<br>(e) vendndodhja gjeografike;<br>(f) kushtet që zbatohen për të hyrë dhe përdorur grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore;<br>(g) autoritetet publike përgjegjëse për ngritjen, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore. | | | përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të nenit 18 të këtij ligji;<br>d) vendndodhja gjeografike;<br>dh) kushtet, në lidhje me aksesin dhe përdorimin e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore;<br>e) autoritetet publike përgjegjëse për krijimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore. | | |
| 11.3 | Shërbimet e transformimit referuar pikës (d) të paragrafit 1 do të kombinohen me shërbime të tjera referuar po këtij paragrafi në një mënyrë të tillë që të mundësojë të gjitha këto shërbime, të cilat do të operojnë në përputhje me rregullat e implementimit parashikuar nga Neni 7(1). | | Ligji nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”<br>Neni 23.4 | Shërbimi i transformimit, i parashikuar nga shkronja “ç” e pikës 1 të këtij neni, duhet të kombinohet me shërbimet e tjera të parashikuara në po të njëjtën pikë, në mënyrë të tillë që të mundësohet vënia në veprim e këtyre shërbimeve, në përputhje me rregullat e ndërveprueshmërisë, të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të nenit 18 të këtij ligji. | E plotë | |
| 12 | Shtetet Anëtare do të garantojnë që autoritetet publike kanë mundësinë teknike për të lidhur grupet dhe shërbimet e të dhënave të tyre hapësinore me rrjetin referuar Nenit 11(1). Ky shërbim do të bëhet gjithashtu I disponueshëm sipas kërkesës për palët e treta, grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore të të cilave përputhen me rregullat e implementimit që përcaktojnë detyrime në lidhje me metadatat në veçanti, dhe me shërbimet e rrjetit | | Ligji nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”<br>Neni 23.2 | Shërbimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni ndërtohen duke mbajtur në konsideratë kërkesat që lidhen me përdoruesit, të cilat duhet të jenë lehtësisht të përdorshme, në dispozicion të publikut dhe të aksesueshme përmes internetit ose çdo mjeti tjetër të përshtatshëm telekomunikacioni. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dhe ndërveprimin. | | | | | |
| 13.1 | Duke anashkaluar Nenin 11(1), Shtetet Anëtare mund të kufizojnë qasjen publike në grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore përmes shërbimeve referuar pikës (a) të Nenit 11(1) ku një qasje e tillë ndikon negativisht në marrëdhëniet ndërkombëtare, sigurinë publike dhe mbrojtjen kombëtare.<br>Duke anashkaluar Nenin 11(1), Shtetet Anëtare mund të kufizojnë qasjen publike në grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore përmes shërbimeve referuar pikëve (b) deri në (e) të Nenit 11(1),<br>(a) konfidencialiteti i procedimeve të autoriteteve publike, ku një konfidencialitet i tillë parashikohet nga ligji;<br>(b) marrëdhëniet ndërkombëtare, siguria publike ose mbrojtja kombëtare;<br>(c) rrjedha e drejtësisë, aftësia e çdo personi për të pasur një gjykim të drejtë ose aftësia e një autoriteti publik për të kryer një hetim të një natyre kriminale ose disiplinore;<br>(d) konfidencialiteti i informacionit tregtar ose industrial, ku një konfidencialitet i tillë parashikohet nga ligji kombëtar ose komunitar për të mbrojtur një interes të ligjshëm ekonomik, | | Ligji nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”<br>Neni 25.1 | ASIG-u dhe autoritetet publike përkatëse kufizojnë aksesin publik te grupet dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore për shërbimet e kërkimit, të përcaktuara nga shkronja “a” e pikës 1 të nenit 23 të këtij ligji, kur prej aksesit mund të rrezikohen siguria publike, mbrojtja kombëtare ose marrëdhëniet ndërkombëtare. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përfshi interesin publik në mirëmbajtjen e konfidencialitetit statistikor dhe fshehtësisë së taksave;<br>(e) të drejtat e pronësisë intelektuale;<br>(f) konfidencialiteti i të dhënave personale dhe/ose dosjeve lidhur me një person fizik kur ai person nuk ka miratuar zbulimin e informacionit për publikun, ku një konfidenticialitet i tillë parashikohet nga ligji kombëtar ose komunitar;<br>(g) interesat ose mbrojtja e çdo personi, që ka siguruar informacionin e kërkuar vullnetarisht pa qenë i detyruar ose vënë nën detyrimin ligjor për të kryer një gjë të tillë, nëse ai person ka dhënë pëlqimin për lëshimin e informacionit përkatës;<br>(h) mbrojtja e mjedisit me të cilin lidhet një informacion i tillë, si vendndodhja e specieve të rralla. | | | | | |
| 13.2 | Arsyet për kufizimin e qasjes, siç parashikohet nga paragrafi 1, do të interpretohen në një mënyrë kufizuese, duke marrë parasysh rastin e veçantë të interesit publik paraqitur nga kjo qasje. Në çdo rast të veçantë, interesi publik i shprehur përmes zbulimit do të peshohet përkundrejt interesit të shprehur përmes kufizimit ose kushtëzimit të qasjes. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br>Neni 25.2 | ASIG-u dhe autoritetet publike kufizojnë aksesin te grupet dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore për shërbimet e parashikuara nga shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" të pikës 1 të nenit 23 të këtij ligji, kur nga aksesi mund të cenohen:<br>a) konfidencialiteti i procedurave të autoriteteve publike, i parashikuar me ligj; | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | b) marrëdhëniet ndërkombëtare, siguria publike ose mbrojtja kombëtare;<br>c) proceset gjyqësore, procesi i rregullt ligjor ose mundësia e autoriteteve publike për të kryer hetime penale ose administrative;<br>ç) konfidencialiteti i informacionit tregtar ose industrial, kur ai parashikohet nga legjislacioni shqiptar<br>ose nga rregullat e një organizate ndërkombëtare, në të cilën Shqipëra është palë, për qëllime të mbrojtjes së<br>interesave të ligjshëm me natyrë ekonomike, përfshirë edhe interesin publik në ruajtjen e konfidencialitetit<br>statistikor dhe sekretin tatimor;<br>d) të drejtat e pronësisë intelektuale;<br>dh) konfidencialiteti i të dhënave personale dhe/ose i dosjeve që lidhen me një person fizik, kur ky i<br>fundit nuk ka dhënë pëlqimin për përhapjen e këtij informacioni, dhe kur konfidencialiteti në lidhje me këtë<br>informacion parashikohet nga ligji;<br>e) interesat ose mbrojtja e çdo personi që ka ofruar vullnetarisht informacionin e kërkuar, pa<br>qenë i detyruar ligjërisht ta bëjë një gjë të tillë, përveçse kur ky person ka dhënë pëlqimin për përhapjen e<br>informacionit;<br>ë) mbrojtja e mjedisit, me të cilin | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | lidhet informacioni, si vendndodhja e specieve të rralla. | | |
| | Bazuar në pikat (a), (d), (f), (g) dhe (h) të paragrafit 1, Shtetet Anëtare nuk mund të kufizojnë qasjen në informacionin e emetimeve në mjedis. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 25.4 | Aksesi te informacioni që lidhet me emetimet në mjedis nuk mund të kufizohet për shkaqet e parashikuara nga shkronjat "a", "ç", "dh", "e" dhe "ë" të pikës 2 të këtij neni. | E plotë | |
| 13.3 | Brenda kësaj strukture, dhe për qëllim të zbatimit të pikës (f) të paragrafit 1, Shtetet Anëtare do të garantojnë që të përputhen kërkesat e Direktivës 95/46/KE. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 25.5 | Për kufizimet e parashikuara nga shkronja "dh" e pikës 2 të këtij neni zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar. | E plotë | |
| 14.1 | Shtetet Anëtare do të garantojnë që shërbimet referuar nga pikat (a) dhe (b) të Nenit 11(1) janë të disponueshme falas për publikun. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 26.1 | Shërbimi i kërkimit dhe i konsultimit, sipas shkronjave "a" dhe "b" të pikës 1 të nenit 23 të këtij ligji, ofrohet falas nga ASIG-u | E plotë | |
| 14.2 | Duke anashkaluar paragrafin 1, Shtetet Anëtare mund të lejojnë një autoritet publik të ofrojnë një shërbim referuar pikes (b) të Nenit 11(1) për të aplikuar tarifa ku tarifa të tilla sigurojnë mirëmbajtjen e grupeve dhe shërbimeve përkatëse të të dhënave hapësinore, veçanërisht në rastet ku përfshihen volume të mëdha të dhënash vazhdimisht të përditësuara. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 26.2 | Përjashtimisht pikës 1 të këtij neni, shërbimi i konsultimit i nënshtrohet pagesës së një tarife, në rast se vendosja e kësaj tarife justifikohet nga kostot veçanërisht të larta të krijimit dhe përditësimit të të dhënave gjeohapësinore të caktuara. | E plotë | |
| 14.3 | Të dhënat e vëna në dispozicion | | | | Nuk transpozohet | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përmes shërbimeve pamore referuar nga pika (b) e Nenit 11(1) mund të jenë në formën e parandalimit të ripërdorimit të tyre për qëllime tregtare. | | | | | |
| 14.4 | Aty ku autoritetet publike vënë taksa për shërbimet e referuar në pikat (b), (c) ose (e) të Nenit 11(1), Shtetet Anëtare do të garantojnë që shërbimet e tregtisë elektronike të jenë të disponueshme. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 24.1, 26 | Neni 24.1<br>Metadatat, të dhënat gjeohapësinore, grupet dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet e rrjetit, të parashikuara nga ky ligj, aksesohen përmes Gjeoportalit Kombëtar.<br>**Neni 26**<br>Shërbimi i kërkimit dhe i konsultimit, sipas shkronjave "a" dhe "b" të pikës 1 të nenit 23 të këtij ligji, ofrohet falas nga ASIG-u.<br>2. Përjashtimisht pikës 1 të këtij neni, shërbimi i konsultimit i nënshtrohet pagesës së një tarife, në rast se vendosja e kësaj tarife justifikohet nga kostot veçanërisht të larta të krijimit dhe përditësimit të të dhënave gjeohapësinore të caktuara.<br>3. Shërbimet e tjera të ofruara nga ASIG-u i nënshtrohen pagesës së tarifave përkatëse.<br>4. Masa e tarifës për shërbim, rregullat për mënyrën dhe afatin e pagimit të tyre, si dhe kriteret e zbatimit të përjashtimit, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni për shërbimin e konsultimit, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të Ministrit të Financave. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shërbimet të tilla mund të mbulohen nga deklaratat e mospranimit, licencat e klikimeve ose, aty ku është e nevojshme, licencat. | | | | Nuk transpozohet | |
| 15.1 | Komisioni do të ngrejë dhe operojë një gjeo-portal Inspire në nivel komunitar. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br><br>Neni 24.3 | Për shërbimin e parashikuar nga shkronja "a" e pikës 1 të këtij neni duhet të zbatohet minimalisht kombinimi i mëposhtëm i kritereve të kërkimit:<br>a) fjalët kyçe;<br>b) klasifikimi i të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimeve që lidhen me to;<br>c) cilësia dhe vlefshmëria e grupeve të të dhënave gjeohapësinore;<br>ç) shkalla e përputhshmërisë me rregullat e ndërveprueshmërisë, të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të nenit 18 të këtij ligji;<br>d) vendndodhja gjeografike;<br>dh) kushtet, në lidhje me aksesin dhe përdorimin e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore;<br>e) autoritetet publike përgjegjëse për krijimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore. | E plotë | |
| 15.2 | Shtetet Anëtare do t'iu ofrojnë qasje shërbimeve referuar nga Neni 11(1) përmes gjeo-portalit Inspire referuar nga paragrafi 1. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br><br>Neni 24.2 | Gjeoportali Kombëtar ndërlidh shërbimet e katalogimit, shërbimet e hartografisë në web dhe shërbimet e rrjetit, të parashikuara nga neni 23 i këtij ligji, me shtresat tematike të krijuara për të dhënat gjeohapësinore për secilën nga temat e parashikuara në pikën 2 të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | nenit 11 të këtij ligji. | | |
| | Shtetet Anëtare mund të ofrojnë gjithashtu qasje në këtë shërbime përmes pikave të tyre të qasjes. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br><br>Neni 24.2 | Gjeoportali Kombëtar ndërlidh shërbimet e katalogimit, shërbimet e hartografisë në web dhe shërbimet e rrjetit, të parashikuara nga neni 23 i këtij ligji, me shtresat tematike të krijuara për të dhënat gjeohapësinore për secilën nga temat e parashikuara në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji. | E plotë | |
| 16 | Rregullat për implementimin projektuar për të amenduar elementet jo thelbësorë të këtij Kapitulli duke e plotësuar atë, do të miratohen në përputhje me procedurën rregullatore shqyrtuese referuar në Nenin 22(3), dhe do të përcaktojë sidomos të mëposhtmet:<br>(a) specifikimet teknike për shërbimet referuar nga Nenet 11 dhe 12 dhe kriteret minmale të performancës për këto shërbime, duke marrë parasysh kërkesat ekzistuese të raportimit dhe rekomandimet e miratuara brenda struktures së legjislacionit mjedisor komunitar, shërbimet ekzistuese të tregtisë elektronike dhe progresin teknologjik;<br>(b) detyrimet referuar nga Neni 12. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br><br>Neni 27 | Kryeministri, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton aktet nënligjore të parashikuara nga neni 9 pika 2 dhe neni 10 pika 2 të këtij ligji.<br>2. Këshilli i Ministrave, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton aktin nënligjor të parashikuar nga neni 6 pika 3 i këtij ligji.<br>3. Këshilli i Ministrave, brenda 3 muajve nga fillimi i veprimtarisë së ASIG-ut, miraton aktet nënligjore të parashikuara nga neni 13 pika 4, neni 16 pika 1, neni 18 pika 3 dhe neni 19 pika 3 të këtij ligji, në bazë të parimeve të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.<br>4. Ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për të dhënat gjeohapësinore, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e aktit nënligjor, të parashikuar nga neni 19 pika 3 e këtij ligji, miratojnë aktin nënligjor të parashikuar nga neni 26 pika 4 i këtij ligji, në bazë të parimit të ofrimit të shërbimeve me cilësi | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përkundrejt kostove efektive.<br>5. ASIG-u, brenda 6 muajve nga fillimi i veprimtarisë së tij, miraton rregullat e parashikuara nga neni 24 pika 3 i këtij ligji. | | |
| 17.1 | 1. Shtetet Anëtare do të adoptojnë masat për ndarjen e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore mes autoriteteve publike<br>referuar nga pika (9)(a) dhe (b) të Nenin 3. Këto masa do t'iu mundësojnë autoriteteve publike të fitojnë qasje në grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore, dhe të shkëmbejnë e të<br>përdorin ato grupe dhe shërbime, për qëllim të detyrave publike<br>që mund të kenë një ndikim në mjedis. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br><br>Neni 19.1 | Autoritetet publike shkëmbejnë ndërmjet tyre grupet dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore, të miratuara nga ASIG-u, sipas pikës 4 të nenit 12 të këtij ligji, duke i garantuar njëri-tjetrit aksesin tek ato dhe<br>përdorimin e tyre për qëllime të ushtrimit të funksioneve të tyre publike. | E plotë | |
| 17.2 | Masat e parashikuara në paragrafin 1 do të pengojnë çdo kufizim të mundshëm të krijojnë pengesa praktike, të cilat ndodhin gjatë përdorimit, për të ndarë grupe dhe shërbime të dhënash hapësinore. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br><br>Neni 19.3 | Rregulla më të hollësishme për shkëmbimin e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore ndërmjet autoriteteve publike miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, duke pasur në konsideratë nevojën e shmangies së kufizimeve që mund të krijojnë pengesa praktike<br>për shkëmbimin e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore, të cilat ndodhin në pikën e<br>përdorimit. | E plotë | |
| 17.3 | Shtetet Anëtare mund të lejojnë | | Përafrohet me projektligjin "Për | Ofrimi i të dhënave dhe shërbimeve | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Autoritetet publike që japin grupe dhe shërbime të dhënash hapësinore të marrin licencën, dhe/ose të kërkojnë pagesë nga autoritetet publike ose institucionet dhe organet e Komunitetit, që përdorin këtë grupe dhe shërbime të dhënash hapësinore. Çdo tarifë dhe licencë e tillë duhet të jetë e pajtueshme me synimin e përgjithshëm të lehtësimit të ndarjes së grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore mes autoriteteve publike. Kur vihen tarifa, këto do të mbahen në nivelin e kërkuar minimal për të garantuar cilësinë e nevojshme dhe plotësimi i grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore së bashku me një kthim të arsyeshëm investimesh, dhe shërbimet e të dhënave hapësinore parashikuar nga Shtetet Anëtare për institucionet komunitare për të përmbushur detyrimet e tyre për raportim sipas legjislacionit komunitar lidhur me mjedisin nuk do t'i nënshtrohet asnjë tarife. | | disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br>Neni 26 | 1.Të dhënat gjeohapësinore të vëna në dispozicion nëpërmjet shërbimeve të rrjetit, sipas pikës 1, të nenit 23 të këtij ligji, ofrohen pa pagesë nga ASIG-u, sipas përcaktimeve në legjislacionin për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik dhe në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm evropian.<br>2.Shërbimet e tjera të ASIG-ut që nuk përfshihen në listën e grupeve të të dhënave me vlerë të madhe, sipas legjislacionit për të dhënat e hapura, mund të ofrohen kundrejt një tarife.<br>3.Metodologjia, masa dhe përdorimi i tarifës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave." | | |
| 17.4 | Marrëveshjet për ndarjen e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore parashikuar nga paragrafët 1, 2 dhe 3 do të jenë të hapura për autoritetet publike referuar pikës (9)(a) dhe (b) të Nenit 3 të Shteteve të tjera Anëtare dhe të institucioneve dhe organeve komunitare, për qëllim të detyrave publike që mund të kenë ndikim në mjedis. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br><br>Neni 25.2<br><br>Vendim nr. 399, datë 19.6.2019 "Për rregullat për shkëmbimin e grupeve dhe të shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore ndërmjet autoriteteve publike" | ASIG-u dhe autoritetet publike kufizojnë aksesin te grupet dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore për shërbimet e parashikuara nga shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" të pikës 1 të nenit 23 të këtij ligji, kur nga aksesi mund të cenohen:<br>a) konfidencialiteti i procedurave të autoriteteve publike, i parashikuar me ligj;<br>b) marrëdhëniet ndërkombëtare, siguria publike ose mbrojtja kombëtare; | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | c) proceset gjyqësore, procesi i rregullt ligjor ose mundësia e autoriteteve publike për të kryer hetime penale ose administrative;<br>ç) konfidencialiteti i informacionit tregtar ose industrial, kur ai parashikohet nga legjislacioni shqiptar ose nga rregullat e një organizate ndërkombëtare, në të cilën Shqipëra është palë, për qëllime të mbrojtjes së interesave të ligjshëm me natyrë ekonomike, përfshirë edhe interesin publik në ruajtjen e konfidencialitetit statistikor dhe sekretin tatimor;<br>d) të drejtat e pronësisë intelektuale;<br>dh) konfidencialiteti i të dhënave personale dhe/ose i dosjeve që lidhen me një person fizik, kur ky i fundit nuk ka dhënë pëlqimin për përhapjen e këtij informacioni, dhe kur konfidencialiteti në lidhje me këtë informacion parashikohet nga ligji;<br>e) interesat ose mbrojtja e çdo personi që ka ofruar vullnetarisht informacionin e kërkuar, pa qenë i detyruar ligjërisht ta bëjë një gjë të tillë, përveçse kur ky person ka dhënë pëlqimin për përhapjen e informacionit;<br>ë) mbrojtja e mjedisit, me të cilin lidhet informacioni, si vendndodhja e specieve të rralla. | | |
| 17.5 | Marrëveshjet për ndarjen e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore parashikuar | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e | ASIG-u dhe autoritetet publike kufizojnë aksesin te grupet dhe shërbimet e të dhënave | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | nga paragrafët 1, 2 dhe 3 do të jenë të hapura, mbi baza reciproke dhe të barasvlershme, për organet e themeluara me marrëveshje ndërkombëtare në të cilat Komuniteti dhe Shtetet Anëtare janë palë, për qëllim të detyrave që mund të kenë ndikim në mjedis. | | Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 25.2<br><br>Vendim nr. 399, datë 19.6.2019 "Për rregullat për shkëmbimin e grupeve dhe të shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore ndërmjet autoriteteve publike | gjeohapësinore për shërbimet e parashikuara nga shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" të pikës 1 të nenit 23 të këtij ligji, kur nga aksesi mund të cenohen:<br>a) konfidencialiteti i procedurave të autoriteteve publike, i parashikuar me ligj;<br>b) marrëdhëniet ndërkombëtare, siguria publike ose mbrojtja kombëtare;<br>c) proceset gjyqësore, procesi i rregullt ligjor ose mundësia e autoriteteve publike për të kryer hetime penale ose administrative;<br>ç) konfidencialiteti i informacionit tregtar ose industrial, kur ai parashikohet nga legjislacioni shqiptar ose nga rregullat e një organizate ndërkombëtare, në të cilën Shqipëra është palë, për qëllime të mbrojtjes së interesave të ligjshëm me natyrë ekonomike, përfshirë edhe interesin publik në ruajtjen e konfidencialitetit statistikor dhe sekretin tatimor;<br>d) të drejtat e pronësisë intelektuale;<br>dh) konfidencialiteti i të dhënave personale dhe/ose i dosjeve që lidhen me një person fizik, kur ky i fundit nuk ka dhënë pëlqimin për përhapjen e këtij informacioni, dhe kur konfidencialiteti në lidhje me këtë informacion parashikohet nga ligji;<br>e) interesat ose mbrojtja e çdo personi që ka ofruar vullnetarisht | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | informacionin e kërkuar, pa qenë i detyruar ligjërisht ta bëjë një gjë të tillë, përveçse kur ky person ka dhënë pëlqimin për përhapjen e informacionit;<br>ë) mbrojtja e mjedisit, me të cilin lidhet informacioni, si vendndodhja e specieve të rralla. | | |
| 17.6 | Aty ku marrëveshjet për ndarjen e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave hapësinore parashikuar nga paragrafët 1, 2 dhe 3 janë bërë të disponueshme në pëprputhje me paragrafët 4 dhe 5, këto marrëveshje mund të shoqërohen nga kërkesa sipas ligjit kombëtar që kushtëzon përdorimin e tyre. | | Vendim nr. 399, datë 19.6.2019 "Për rregullat për shkëmbimin e grupeve dhe të shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore ndërmjet autoriteteve publike | | E plotë | |
| 17.7 | Duke anashkaluar këtë Nen, Shtetet Anëtare mund të kufizojnë ndarjen kur kjo do të kompromentonte rrjedhën e drejtësisë, sigurinë publike, mbrojtjen kombëtare ose marrëdhëniet ndërkombëtare. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br><br>Neni 19.2 | Shkëmbimi i të dhënave, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të kufizohet me vendim të ASIG-ut, në rastet kur prej tij rrezikohen proceset gjyqësore, siguria publike, mbrojtja kombëtare ose marrëdhëniet ndërkombëtare. | E plotë | |
| 17.8 | Shtetet Anëtare do t'iu japin institucioneve dhe organeve të Komunitetit qasje në grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore në përputhje me kushtet e harmonizuara. Rregullat e implementimit që përcaktojnë këto kushte projektuar për të amenduar elementet jo thelbësorë të kësaj Direktive duke i plotësuar, do të miratohen në përputhje me procedurën rregullatore shqyrtuese referuar nga Neni 22(3). Këto rregulla implementimi do të respektojnë plotësisht parimet e parashikuar në paragrafët 1 deri në 3. | | | | Nuk transpozohet | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 18 | Shtetet Anëtare do garantojnë që strukturat dhe mekanizmat e përshtatshme janë projektuar për koordinim, në nivele të ndryshme qeverisëse, kontributet e të gjithë atyre me një interes në infrastrukturën për informacionin hapësinor.<br>Këto struktura do të koordinojnë, ndër të tjera, kontributet e përdoruesve, prodhuesve, ofruesve të shërbimeve me vlerë të shtuar dhe organeve koordinuese, lidhur me identifikimin e grupeve të të dhënave përkatëse, nevojave të përdoruesve, dispozitën e informacionit mbi praktikat ekzistuese dhe dispozitën e reagimeve në implementimin e kësaj Direktive. | | Ligji nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”<br><br>Neni 20, 21 | **Neni 20**<br>Bashkërendimi ndërinstitucional<br>1. ASIG-u, në përputhje me përgjegjësitë e tij sipas këtij ligji, bashkërendon veprimet dhe nismat e autoriteteve publike në fushën e informacionit gjeohapësinor. ASIG-u siguron bashkërendimin ndërinstitucional për:<br>a) mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore;<br>b) përcaktimin e standardeve shtetërore dhe të rregullave uniforme;<br>c) investimet në sektorin e të dhënave gjeohapësinore.<br>2. Autoritetet publike i paraqesin ASIG-ut kërkesën për vlerësimin e çdo nisme në fushën e infrastrukturës së të dhënave gjeohapësinore, e cila përmban të dhëna teknike dhe financiare të plota, si dhe shoqërohet me dokumentacionin teknik dhe financiar përkatës.<br>3. ASIG-u, brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, sipas pikës 2 të këtij neni, i përcjell për mendim BIG-ut kërkesën e autoritetit publik dhe dokumentacionin teknik e financiar përkatës.<br>4. ASIG-u, pasi merr mendimin e BIG-ut, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i përcjell autoritetit publik rekomandimin e tij të arsyetuar për | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | nismën. Rekomandimi i ASIG-ut publikohet në Gjeoportalin Kombëtar.<br>**Neni 21**<br>Rekomandimi i ASIG-ut për nismat e autoriteteve publike<br>Në rekomandimin e ASIG-ut drejtuar autoritetit publik përfshihen:<br>a) sugjerime teknike dhe financiare për realizimin e nismës;<br>b) mendime për standardet dhe rregullat që duhet të zbatojë autoriteti publik;<br>c) të dhëna për autoritetet e tjera publike, të përfshira në këtë nismë;<br>ç) të dhëna për nisma dhe veprime që janë në proces zbatimi ose janë përfunduar e dorëzuar nga autoritete të tjera publike, të cilat duhen mbajtur parasysh gjatë procesit të zbatimit të nismës;<br>d) çdo rekomandim tjetër që konsiderohet i rëndësishëm për mbarëvajtjen e procesit të zbatimit të nismës. | | |
| 19.1 | Komisioni do të ketë përgjegjësinë për koordinimin e Inspire në nivel komunitar dhe për këtë qëllim do të asistohet nga organizatat përkatëse dhe, në veçanti, nga Agjencia Evropiane e Mjedisit. | | | | Nuk transpozohet | |
| 19.2 | Secili Shtet Anëtar do të caktojë një pikë kontakti, zakonisht një autoritet publik, për të qenë përgjegjës për kontaktet me | | Ligji nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të | 1. Autoritetet kombëtare përgjegjëse për informacionin gjeohapësinor janë Autoriteti Shtetëror I Informacionit Gjeohapësinor (ASIG), Bordi i | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Komisionin lidhur me Direktivën. Kjo pikë kontakti do të mbështetet nga një strukturë koordnimi, duke marrë parasysh shpërndarjen e kompetencave dhe përgjegjësive brenda Shtetit Anëtar. | | Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”<br><br>Neni 5 | Informacionit Gjeohapësinor (BIG) dhe autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor, sipas legjislacionit në fuqi.<br>2. ASIG-u është institucion vendimmarrës, ekzekutiv dhe koordinues që mbikëqyr zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.<br>3. BIG-u është organ këshillimor që ushtron veprimtarinë e tij me kohë të pjesshme dhe mblidhet sa herë që është e nevojshme për realizimin e veprimtarisë së përcaktuar sipas pikës 2 të nenit 10 të këtij ligji.<br>4. Autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor janë autoritetet e parashikuara në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, ngarkohen me këto përgjegjësi. | | |
| 20 | Rregullat e implementimit referuar nga kjo Direktivë do të marrin parasysh standardet e miratuara nga organet evropiane të standardizimit në përputhje me procedurën e parashikuar në Direktivën 98/34/KE, si dhe me standardet ndërkombëtare. | | Ligji nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”<br><br>Neni 16.3 | Në përcaktimin e standardeve shtetërore, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, ASIG-u mban në konsideratë standardet europiane, të miratuara nga organizmat standardizues europianë. | E plotë | |
| 21.1 | Shtetet Anëtare do të monitorojnë implementimin dhe përdorimin e infrastrukturës së tyre për informacion hapësinor. | | Përafrohet me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë” | 1.ASIG-u monitoron procesin e krijimit dhe përdorimit të infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor (NSDI) në Republikën e Shqipërisë; | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Neni 22/1 (1) | | | |
| | Ata do t'i bëjnë rezultatet e këtij monitorimi të aksesueshëm për Komisionin dhe publikun në mënyrë të përhershme. | | Përafrohet me projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 22/1 (2) | 2.ASIG-u përgatit raporte periodike për ecurinë e NSDI-së në Shqipëri, sipas modelit të përcaktuar në rregulloren zbatuese të Direktivës 2007/2/EC dhe ia vë në dispozicion institucioneve të brendshme dhe organeve të BE-së. | E plotë | |
| 21.2 | Jo më vonë se 31 Mars të çdo viti Shtetet Anëtare do t'i dërgojnë Komisionit një raport ku përfshihet përshkrimi përmbledhës i:<br>(a) mënyrës si janë koordinuar ofruesit e sektorit publik dhe përdoruesit e grupeve e shërbimeve të të dhënave hapësinore si dhe organeve ndërmjetëse, gjithashtu edhe të marrëdhënies me palët e treta dhe organizimit të sigurimit të cilësisë;<br>(b) kontributit të bërë nga autoritetet publike ose palët e treta për funksionimin dhe koordinimin e infrastrukturës për informacionin hapësinor;<br>(c) informacionit mbi përdorimin e infrastrukturës së informacionit hapësinor;<br>(d) marrëveshjet e ndarjes së të dhënave mes autoriteteve publike;<br>(e) kostot dhe përfitimet e implementimit të kësaj Direktive. | | Përafrohet me projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"<br>Neni 22/1 | Monitorimi dhe raportimi<br><br>1.ASIG-u monitoron procesin e krijimit dhe përdorimit të infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor (NSDI) në Republikën e Shqipërisë;<br><br>2. ASIG-u përgatit raporte periodike për ecurinë e NSDI-së në Shqipëri, sipas modelit të përcaktuar në rregullat e legjislacionit evropian dhe ia vë në dispozicion institucioneve të brendshme dhe organeve të BE-së.".. | | |
| 21.4 | Rregullat e hollësishme për implementimin e këtij Nenin do të miratohen në përputhje me procedurën rregullatore referuar nga<br>Neni 22(2). | | | | Nuk transpozohet | |
| 22.1 | Komisioni do të asistohet nga një komitet. | | | | Nuk transpozohet | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 22.2 | Kur i bëhet referencë këtij paragrafi, do të zbatohen Nenet 5 dhe 7 të Vendimit 1999/468/EC, duke pasur parasysh dispozitat e Nenit 8. Periudha e parashikuar në Nenin 5(6) të Vendimit 1999/468/EC do të caktohet për tre muaj. | | | | Nuk transpozohet | |
| 22.3 | Kur i bëhet referencë këtij paragrafi, do të zbatohet Neni 5a (1) deri në Nenin 7 të Vendimit 1999/468/EC, duke pasur parasysh dispozitat e Nenit 8. | | | | Nuk transpozohet | |
| 23 | Agjencia Europiane e Mjedisit do të publikojë dhe do të përditësojë çdo vit pasqyrën e përgjithshme të Komunitetit, në bazë të metadateve dhe të dhënave të bëra të disponueshme nga Shtetet Anëtare përmes shërbimeve të tyre rrjetore në përputhje me Nenin 21. Pasqyra e përgjithshme e Komunitetit do të përfshijë, sipas rastit, tregues për rezultatet, rezultatet dhe ndikimet e kësaj Direktive, hartat e përgjithshme të Bashkimit dhe raportet e pasqyrave të Shteteve Anëtare. Komisioni duhet, jo më vonë se 1 janar 2022 dhe të paktën çdo pesë vjet më pas, të kryejë një vlerësim të kësaj Direktive dhe të zbatimit të saj dhe ta bëjë atë të disponueshme për publikun. Ky vlerësim do të bazohet, ndër të tjera, në elementet e mëposhtme:<br>(a) përvoja e mbledhur nga zbatimi i kësaj Direktive;<br><br>(b) informacioni i mbledhur nga Shtetet Anëtare në përputhje me Nenin 21 dhe pasqyrat e përgjithshme të Bashkimit të kompiluara nga Agjencia Europiane e Mjedisit;<br>(c) të dhëna shkencore dhe analitike relevante; | | | | Nuk transpozohet | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (d) informacion tjetër, përfshirë të dhëna shkencore dhe analitike relevante të nevojshme në bazë të udhëzimeve për rregullimin më të mirë, duke u mbështetur në proceset efikase dhe efektive të menaxhimit të informacionit. | | | | | |
| 24.1. | Shtetet Anëtare do të sjellin në fuqi ligjet, rregulloret dhe dispozitat e nevojshme për zbatimin e kësaj Direktive brenda 15 Maj 2009. Kur Shtetet Anëtare adoptojnë këto masa, do t'i përmbahen një reference nga kjo Direktivë ose do të shoqërohen nga një referencë e tillë në rastin e publikimit të tyre zyrtar. Metodat e krijimit të një reference të tillë do të përcaktohen nga Shtetet Anëtare. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" | | E plotë | |
| 24.2 | Shtetet Anëtare do t'i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të ligjit kombëtar, të cilin e miratojnë në fushën e përfshirë nga kjo Direktivë. | | | | Nuk transpozohet | |
| 25 | Kjo Direktivë do të hyjë në fuqi në ditën e 20-të pas publikimit të saj në Revistën Zyrtare të Bashkimit Evropian. | | Ligji nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" Neni 30 | Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Miratuar në datën 28.6.2012 | E plotë | |
| 26 | | | | | Nuk transpozohet | |
| Annex I | | | Ligji nr.72/2012, "Për | | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”<br><br>Neni 11.2(a…g) | | | |
| Annex II | | | Ligji nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”<br><br>Neni 11.2 (gj, h, i, j) | | E plotë | |
| Annex III | | | Ligji nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”<br>Neni 11.2 (k…Z) | | E plotë | |